



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik
Municipality of Kaçanik

01Nr.104/02-7676/22
Kaçanik, 31.03.2022

Në mbështetje të nenit 12.2(d) lidhur me nenin 17 të Ligjit nr. 03/L-040-Për Vetëqeverisjen lokale (Gazeta Zyrtare Nr. 28/4 Qershor 2008), të nenit 6.2 të Statutit të Komunës, të Propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës 01Nr.104/02-7676/22(bashkëngjitur), Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e mbajtur me 31 Mars 2022, mori këtë:

VENDIM
PËR DHËNIEN NË MENAXHIM TË PËRKOHSHËM, PARKINGJET NË PRONËSI TË
KOMUNËS, NDËRMARRJES PUBLIKE KRM "PASTËRTIA " SH.A-NJËSIA NË
KAÇANIK

1. Me këtë Vendim, ipen në menaxhim të përkohshëm, parkingjet publike në pronësi të komunës, Ndërmarrjes publike komunale KRM "Pastërtia" sh.a-njësia në Kaçanik.
2. KRM "Pastërtia" sh.a-njësia në Kaçanik do t'i mirëmbajë dhe inkasoj mjetet që gjenerohen nga vend-parkingjet e komunës.
3. Mjetet e inkasuar do të shfrytëzohen nga KRM "Pastërtia"-njësia në Kaçanik, e njëjta do t'i përdorë për nevojat e funksionimit të kompanisë.
4. Tarifat e shfrytëzimit të vend-parkingjeve caktohen në bazë të Rregullores për Taksa komunale.
5. KRM "Pastërtia" sh.a-njësia në Kaçanik në kundërvlerë të këtij aktiviteti do t'i mirëmbajë hapësirat publike (bulevardin "Ismajl Raka", shëtitoret përgjatë lumit Nerodime, Parkun e Qytetit dhe hapësira tjera sipas marrëveshjes me komunën).
6. Të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë mes komunës dhe KRM "Pastërtia" sh.a-njësia në Kaçanik do të precizohen përmes një marrëveshje "në shtëpi" (in house) e rregulluar konform ligjeve në fuqi.
7. Për zbatimin e këtij vendimi do të përkujdeset, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencave.
8. Ky Vendim hyn në fuqi sipas nenit 17 të Rregullores (MAPL) Nr.01/2017- për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të komunës.

Me këtë vendim njoftohen: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencave (përmes kësaj drejtorie njoftohen organet tjera relevante), Drejtoria e Buxhetit dhe Financave dhe Arkivi.

Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Murseli



Makfire Malsiu

From: Gëzim Sahiti
Sent: Thursday, April 21, 2022 11:26 AM
To: Makfire Malsiu

E nderuar ju njoftoj se 3 vendimet e me poshtme bazuar ne Rregulloren, (QRK) nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës nuk ju nënshtrohen vlerësimit ligjshmërisë

1. Propozim Vendimi për dhënien në menaxhim të përkohshëm të parkingjeve në pronësi të komunës, Ndërmarrjes publike 'Pastërtia' SH.A. Njësia Kaçanik; rregullohet me Nenin 26 të Rregullores (QRK) nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunë

Sipas shtojcës 2 te Rregullores (QRK) nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunë

2. Plani i punës i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSBB), për vitin 2022;
3. Plani vjetor i punës së Komitetit Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuara në Kaçanik, për vitin 2022.

Me respekt,

Gëzim Sahiti
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Zyrtar i Lartë për Monitorim të Komunave DLMK

Adresa: Rr. "Garibaldi", Ndërtesa Qeveritare ish "Rilindja", Kati XI
10 000 Prishtinë
Telefoni: Cnx. 038/200-35-574 Mob,
Mob: +38349 666 -411, +383 44 393-313